

STATUT

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Albania Solar Power shpk

Date 22.02.2024

Ne kete statut :

“Ligj “ – eshte ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 “ Per Tregtaret dhe shoqerite Tregtare , i ndryshuar

“Statut “- është Statuti i shoqërisë “Albania Solar Power ” shpk

Kreu I

THEMELIMI ,EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1 – Data e Themelimit , Emri dhe Themeluesit

1.1 Sot me date 22.02.2024 une themeluesi kam krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me “Albania Solar Power ” shpk

1.2 Themeluesit e shoqerise jane :

Engjell Agalliu , i datelindjes 26.09.1985 , lindur ne Terpan , Banues ne Tirane pajisur me dokument identifikimi me nr. 034560149 dhe Nr. Personal 150926124V, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Neni 2 – Objekti

2.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike. Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë. Projektim, realizim impiante prodhimi energji elektrike me burime te gjenerueshme , Sistem fotovoltaik, panele diellore etjer. Tregtim brenda dhe jashtë vendit te energjisë, prodhimin dhe përpunimin e saj. Furnizim me energji elektrike te klientëve fundore qe veprojnë ne treg te rregulluar e përcaktuar nga legjislacioni ne fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare te shërbimit, si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë. Realizimi i aktivitetit ne fushen e ndërtimit , ndërtim rruge , godina etjer

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë, impianteve/paneleve fotovoltaike/eulike.

Ofrimi i konsulencës dhe asistencës teknike për projektimin, studimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrje, kolaudim, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, eulike dhe të çdo materiali tjetër ndihmës të sistemit dhe rrjetit elektrik.

Import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, elektro shtëpiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike, sisteme për mirëmenaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuar për objekte civile dhe industriale.

Shitja me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike, dhe të materialeve të ndryshme elektrike/fotovoltaike e eulike dhe pajisjeve të tyre, duke përfshirë të gjitha elementet e impianteve të energjisë alternative.

Shërbimet e shoqërisë konsistojnë por pa u kufizuar në ofrimin e konsulencës në fushën e marketingut promovimi, reklamimi, shërbimi ndaj klientit, diferencimi, segmentimi, shitje direkte, marketing online, taktikat e marketingut, marrëdhëniet me publikun. Ofrimi i shërbimeve imobiliare, ndermjetësim, shitblerje të pronave të paluajtshme, dhënie me qira/nën qira të pasurive të paluajtshme etj;

2.2 Shoqëria do të realizojë, direkt apo indirekt, çdo lloj aktiviteti lidhur me, si rezultat i, apo që ka lidhje me objektin e saj. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.

2.3 Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

Neni 3 – Kohëzgjatja

3.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e **pa kufizuar**.

Neni 4 – Selia

4.1 Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: *Rruga Eduard Mano, Nd 18, H.7 Ap 21, Farke Selite 1044 Tirane*

4.2 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

4.3 Adresa e Shoqërisë për qëllim të komunikimeve elektronike është:

engjell1985@hotmail.com

4.4 : Numri i telefonit : +355698681860

KREU II Kapitali

Neni 5 Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë **është 100,000 lek**. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

- Ortaku themelues zoteron nje kuote me vleren **100.000 Lek** e cila perben **100%** te kapitalit themeltar te shoqerise

5.2 Kontributi i ortakeve eshte ne para.

5.3. Çdo kuote i jep zoteruesit te drejten e nje vote ne vleren e kuotes.

5.4 Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.

5.5 Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortaku në emrin e tij personal ndaj personave të tretë.

Neni 6

Zmadhimi

6.1 Ortaku i vetëm mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.

6.2 Administratorët njoftojnë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë.

6.3 Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 7

Zmadhimi i kapitalit me aktive të Shoqërisë

7.1 Pas miratimit të bilancit të vitit paraardhës, ortaku i vetëm mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.

7.2 Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.

7.3 Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i vitit paraardhës rezulton me humbje.

Neni 8

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

8.1 Ortaku i vetëm mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

8.2 Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 9

Transferimi i kuotave

9.1 Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen lirisht të tretëve, tërësisht ose pjesërisht.

9.2 Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre, mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Neni 10 Pasojat e kalimit të kuotave

10.1. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit

Neni 11 Regjistri i Ortakeve

11.1 Pronesia mbi kuotat do te regjistrohet ne regjistrin e ortakeve qe do te mbahet ne seline e Shoqerise nen pergjegjesine e Administratorit (“Regjistri i Ortakeve”).

11.2 Regjistri i Ortakeve do te pasqyroje informacionin e meposhtem: (i) identitetin e cdo Ortaku; (ii) numrin dhe vleren e kuotave qe i perkasin çdo Ortaku; (iii) daten e fitimit te pronesise se secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresen apo seline e cdo Ortaku; (v) detaje per cdo peng apo barre te vendosur mbi kuotat.

KREU III Organet vendimarrëse dhe drejtuese

Neni 12 Organet e Shoqerise

12. Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve e perbere nga ortaku i vetem;
- Administratori.

Neni 13 Organi vendimarrës

13.1 Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise e cila perfaqeson unanimitetin e Ortakeve.

13.2 Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimarrës i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj te cilat jane te detyrueshme per te gjithë ortaktet e shoqerise edhe ne rastin se ata mungojne apo nuk shprehin voten e tyre pro apo kundra qe nga dita qe kane marre njoftimin sipas parashikimit ne statut.

13.3 Asambleja e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine, per çeshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;



- b) ndryshimin e statutit;
- c) emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- ç) emerimin e shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç”, te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe proçedimet e tera ndaj admnistratoreve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave proçeduriale te mbledhjeve te asamblese;
- i) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” i ndryshuar

Neni 14

Procesverbali i mbledhjes se asamblese

- 14.1 Te gjitha vendimet e Asamblese se ortakeve duhet te regjistrohen ne procesverbal.
- 14.2 Administratori pergjigjet per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.
- 14.3 Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e mbajtjesit te procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesemarresve, si, akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme dhe njoftimet dhe letermarrjet/konfirmimet e ortakeve.
- 14.4 Procesverbali i mbledhjes nenshkruset nga anetaret pjesemarres dhe nga mbajttesi i procesverbalit.

Neni 15

Administrimi

- 15.1 Shoqëria administrohet nga administratorët. Asambleja e Ortakeve emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje.
- 15.2 Asambleja e Ortakeve e perbere nga Ortaku i vetem emeron administrator te shoqerise **Engjell Agalliu** , i datelindjes 26.09.1985 , lindur ne Terpan , Banues ne Tirane pajisur me dokument identifikimi me nr. 034560149 dhe Nr. Personal I50926124V, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.
- 15.3 Afati i emërimit është 5 vjet, me te drejte riemerimi.
- 15.4 Emerimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.
- 15.5 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë osë ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 16



Kompetencat e administratorit .

16.1 Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetëm;
- b) përfaqësojnë Shoqërinë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

16.2 Ortaku i vetëm mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.

16.3 Administratorët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale

Neni 17

Pergjegjesite e administratorit .

17.1 Administratori është përgjegjes individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve , për shkelje të ligjeve , për shkelje të statutit apo për faje të kryer gjatë administrimit të shoqërisë.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 ligjit për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , administrator detyrohet:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; ç) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë; d) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të ligjit; dh) të ushtrojnë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

17.2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë

tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

- 17.4. Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare

KREU IV VITI FINANCIAR – EKSPERTËT

Neni 18 Viti financiar dhe dividenti

- 18.1 Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 19 Ekspertet

- 19.1 Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë së shoqërisë, të Administratorit si dhe mbi gjitë aktivitetin e shoqërisë i besohet. Kohezgjatja e veprimtarisë së ekspertit dhe shperblimi caktohen me vendim të Asambleja e ortakeve
- 19.2 Eksperti, në fund të periudhës së kontrollit, harton raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar dhe detyrohet t'ua dorëzojë të gjithë ortakeve për të shqyrtuar në bazë të drejtës vendimore që ka. Ortaku i vetëm ka të drejtë të marrë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Neni 20 Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë

- 20.1 Shperndarja ose prishja e shoqërisë bëhet në çdo kohë :
- (i) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj
 - (ii) me vendim të asamblese së ortakeve
 - (iii) kur Shoqëria nuk ka kryer veprimtari për 2 (dy) vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKR; ose
 - (iv) me vendim gjykate;
 - (v) për arsye të tjera të parashikuara në ligj.
- 20.2 Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendres Kombetare të Regjistrimit nga Administratori.



Neni 21
Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja

21.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes të Asamblesë së Orakeve , në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën e IX të Ligjit 9901 date 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 22
Norma referuese

- 22.1 Persa nuk parashikohet ne kete statut do te behet referimi ne ligjet e miratuara dhe ato ne fuqi ne republiken e Shqiperise ne fushen e shoqerive tregtare.
- 22.2 Autoritetet Gjyqesore Shqiptare jane ato te cilat kane kompetencen ekskluzive per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin midis ortakve apo midis tyre dhe Organeve te shoqerise.

Neni 23
Dispozita te pergjithshme

- 23.1 Persa eshte shprehur ne kete statut i referohemi Ligjit nr. 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar.
- 23.2 Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.
- 23.3 Ky Statut hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.
- 23.4 Gjithçka qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te rregullohet nga legjislacioni tregtar, Ligji nr. 9901 dt 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne fuqi ne Republikën e Shqiperise.
- 23.5 Ky Statut perpilohet ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqip me te njejten vlere, dhe nenshkruhet pa verejtje nga ortaku i vetem themelues.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

ENGJELL AGALLIU

Engjell Agalliu
